



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Janar 2021

Nr: 16

VENDIM

**PËR MOSFILLIM TË PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË DENONCIMEVE NR. 409 DATË 05.01.2021 DHE NR. 564, 566, 568 DATË 09.01.2021, PËR SHKELJE TË PARASHIKUAR NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020 TË KOMISIONIT RREGULLATOR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VËREJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë raportuar disa denoncime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), për shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit më datë 09.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 564 ora 18:01, pretendohet se: “Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, më datë 25.12.2020 ka publikuar në faqen e tij Facebook një veprimtari ku Ministri i Rindërtimit Arben Ahmetaj sëbashku me Kryetarin e Bashkisë së Shijakut, Elton Arbana i kanë dorëzuar çelësin e shtëpisë së rindërtuar nga tërmeti dy familjeve në Maminas, Shijak”.

Sipas denoncuesit “Ministri i Rindërtimit Arben Ahmetaj dhe Kryetari i Bashkisë së Shijakut Elton Arbana janë subjekt i vendimit nr.9 datë 24.12.2020 të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”.



Data: 28 Janar 2021  
Nr. 16

Për mosfillim të procedurës administrative të denoncimeve nr. 409 datë 05.01.2021 dhe nr. 564, 566, 568 datë 09.01.2021 për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit më datë 09.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 566 ora 18:02, pretendohet se: *“Më datë 31.12.2020 Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama ka publikuar në faqen e tij Facebook një veprimtari ku ka dorëzuar çelësat e banesës së rindërtuar nga tërmeti qytetarëve në Maminas, Shijak sëbashku me Kryetarin e Bashkisë Shijak, Elton Arbana”*.

Sipas denoncuesit *“Veprimi i Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama dhe Kryetarit të Bashkisë Shijak, Elton Arbana bie ndesh me vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”*.

Sipas denoncimit më datë 09.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 568 ora 18:02, pretendohet se: *“Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, më datë 31.12.2020, ka publikuar në faqen e tij Facebook disa veprimtari ku ka dorëzuar çelësat e banesës së veprimtari ku ka dorëzuar banesën e rindërtuar nga tërmeti qytetarëve në XhafZotaj, Shijak sëbashku me Kryetarin e Bashkisë Shijak Elton Arbana”*.

Sipas denoncuesit *“Veprimi i Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama dhe Kryetarit të Bashkisë Shijak Elton Arbana bie ndesh me vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”*.

Sipas denoncimit më datë 05.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 409 ora 14:44, pretendohet se: *“Më datë 31.12.2020 në faqen zyrtare “Shqiptarja.com” është publikuar lajmi i zhvillimit të një aktiviteti me karakter publik nga Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, gjatë të cilit ai u jep çelësat e shtëpive të rindërtuara pas tërmetit disa familjeve në Shijak”*.

Sipas denoncuesit *“Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama është subjekt i vendimit nr.9 datë 24.12.2020 të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”*.

*“Përsa mësipër kërkohet shqyrtimin e rastit nga ana juaj dhe marrjen e masave sipas parashikimeve të vendimit të mësipërm”*.

Sipas përcaktimeve të nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tyre.

Referuar sa më sipër Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi shqyrtimin bashkërisht të denoncimeve pasi konstatoi se kishin të njëjtin subjekt dhe objekt, në të cilat pretendohet shkelje të parashikuara në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, shkronja “d” të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.



Referuar sa më sipër ndalimi lidhet vetëm në rastet kur veprimtaria publike është veprimtari e ndaluar në kuptim të përkufizimeve të veprimtarive të ndaluara dhe subjekteve të përcaktuara në nenin 3 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në rast se fondet janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve .

Neni 92 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, përcakton detyrimin e institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve.

Referuar aktiviteteve dhe veprimtarive të publikuara në faqen e Facebook të Kryeministrit, këto veprimtari janë raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Kryeministri sipas parashikimeve të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe rrjedhimisht pjesëmarrësit e ftuar nuk mbartin detyrimin e raportimit të dyfishtë për sa kohë që eventit është raportuar nga organizuesi i aktivitetit. Gjithashtu vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nuk parashikon efekte prapavepruese apo dispozita tranzitore për aktivitete të planifikuara nga institucionet publike para miratimit të tij.

Referuar denoncimeve të mësipërme këto veprimtari të subjekteve të sipër përmendura nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të provojnë se janë veprimtari të ndaluara në kuptim të përkufizimeve të veprimtarive të ndaluara të përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak se kallëzimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:



## **V E N D O S:**

1. Mosfillimin e procedurës administrative për shkak se kallëzimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 28 Janar 2021

Nr. 16

Për mosfillim të procedurës administrative të denoncimeve nr. 409 datë 05.01.2021 dhe nr. 564, 566, 568 datë 09.01.2021 për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.